



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.158**

**1 dhjetor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 347 datë 4.11.2010	Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës ..... 8287
Ligj nr.10 350 datë 11.11.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar ..... 8299
Ligj nr.10 351 datë 11.11.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar ..... 8301
Vendim i KM nr.853, datë 21.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sarandë-Krane-Konispol ..... 8304
Udhëzim i MASH nr.33, datë 1.11.2010	Për kriteret dhe procedurat e shqyrtimit të kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare ..... 8310
Udhëzim i MASH nr.35, datë 5.11.2010	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë, të studimeve me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011..... 8315
Udhëzim i MD nr.4846/33, datë 3.11.2010	Për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit pas çregjistrimit të përmbaruesit gjyqësor privat ..... 8317
Vendim i ERE nr.79, datë 3.11.2010	Për ndryshimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “AMAL” sh.p.k. me seri Pv03k, nr.09 lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të ERE-s nr.18, datë 16.10.2003 ..... 8318

Vendim i ERE nr.80, datë 3.10.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Ferar Energy” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike .....	8319
Vendim i KKRT nr.187, datë 22.10.2010	Për vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv AOS” .....	8320
Vendim i KKRT nr.188, datë 22.10.2010	Për vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Color” .....	8321
Vendim i KKRT nr.191, datë 22.10.2010	Për miratimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrje licence nga personi fizik z.Ardian Dardha, licencuar për subjektin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Luna” .....	8322

**LIGJ**  
**Nr.10 347, datë 4.11.2010**

**PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:  
KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
**Objekti**

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës, që garantojnë realizimin me efektivitet të mbrojtjes së këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijën.

Neni 2  
**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbrojtjen e veçantë të të drejtave të fëmijës nëpërmjet realizimit të një kuadri të plotë ligjor dhe institucional, në zbatim të Kushtetutës, të akteve ndërkombëtare që veprojnë në këtë fushë, si dhe të legjislacionit në fuqi;
- b) marrjen e masave për t'i siguruar fëmijës ushtrimin e të drejtave, në përputhje me zhvillimin e personalitetin, bazuar në interesin më të lartë të tij;
- c) marrjen e masave për të siguruar jetesën, mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës;
- ç) sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave dhe autoriteteve qendrore e vendore, si dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e fëmijës.

Neni 3  
**Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "Autoritet shtetëror përgjegjës" është organi ose institucioni shtetëror, në nivel qendror a vendor, i cili, brenda fushës së veprimtarisë së tij, kryen dhe mbulon shërbime të specializuara e profesionale për fëmijët.
- b) "Dhunë ndaj fëmijëve" është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose i formave të tjera të forcës, qoftë me kërcënim ose aktuale, kundër fëmijës a grupit të fëmijëve, e cila rezulton apo ka shumë të ngjarë që të rezultojë në dëmtim, vdekje, dëmtim psikologjik, keqzhvillim ose privim.
- c) "Dhuna psikologjike" përfshin veprimet që shkaktojnë dëmtime të shëndetit fizik, mendor, moral dhe social të fëmijës dhe që, ndër të tjera, kanë sjellë si pasojë kufizimin e lirisë së lëvizjes, sjellje degraduese, kërcënuese, frikësuese, diskriminuese, përqeshëse ose forma të tjera të trajtimit armiqësor apo refuzues nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, një i afërm i familjes ose çdo person tjetër që e ka për detyrë të kujdeset për fëmijën.
- ç) "Dhunë fizike" është çdo tentativë ose çdo dëmtim fizik apo plagosje e fëmijës, përfshirë edhe ndëshkimin trupor të tij, të cilat nuk janë aksidentale.
- d) "Fëmijë" është çdo person i lindur gjallë, deri në moshën 18 vjeç. Në rastin kur mosha e personit nuk është plotësisht e përcaktuar, por ekzistojnë arsye që lënë të nënkuptohet se personi është fëmijë, ky person konsiderohet fëmijë dhe përfiton nga ky ligj derisa mosha e tij të jetë përcaktuar plotësisht.

dh) “Fëmijë në rrezik” është fëmija, të cilit i mohohen ose i cenohen të drejtat dhe mbrojtja e parashikuar në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi.

e) “Mbrojtje e fëmijës” është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikat e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjenitale dhe martesë e fëmijëve.

ë) “Multidisiplinar” është vlerësimi i koordinuar ligjor, social, psikologjik, shëndetësor, arsimor dhe kulturor i gjendjes së fëmijës.

f) “Ndëshkimi trupor” është çdo lloj ndëshkimi që përdor forcën fizike dhe që synon të shkaktojë dhimbje ose shqetësim, sado të lehta qofshin këto, nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, përfaqësuesi ligjor, të afërmit ose çdo person tjetër ligjërishit përgjegjës për fëmijën. Në ndëshkimin trupor përfshihen forma të tilla, si: rrahja, tortura, shkundja/shtytja me forcë, djegia, goditja (shuplakë ose shkelm), pickimi, çjerrja, kafshimi, qortimi i rreptë, detyrimi me forcë për të kryer një veprim, përdorimi i lëndëve që shkaktojnë dhimbje ose shqetësim.

g) “Ndërhyrje e paligjshme për ruajtjen e identitetit” është moslejimi i përdorimit të gjuhëve të pakicave kombëtare në sistemin arsimor e në media; persekutimi shtetëror apo shtypja e besimit fetar; mosnjohja e mundësisë për fëmijët jashtë kujdesit prindëror, të cilët janë vendosur në institucione, familje kujdestare apo të birësuar, që të gëzojnë trashëgiminë e tyre etnike, kulturore, gjuhësore dhe fetare.

gj) “Prind” është personi/personat që e kanë lindur ose e kanë birësuar fëmijën të dy së bashku ose një i vetëm, të martuar ose të pamartuar apo që kanë njohur amësinë ose atësinë e fëmijës së lindur jashtë martese.

h) “Përfaqësues ligjor” është kujdestari ose familja kujdestare, personi apo institucioni, i cili, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji ose nga gjykata, mbron interesat e fëmijës nëpërmjet kryerjes apo jo të veprimeve juridike, në emër ose për llogari të fëmijës.

i) “Prostitucion i fëmijëve” është përdorimi i fëmijëve në veprimtaritë seksuale, me qëllim shpërblimi ose çdo forme tjetër që konsiderohet shpërblim;

j) “Pornografi e fëmijëve” është prodhimi, shpërndarja, importimi, eksportimi, mbajtja, ofrimi, shitja, shfaqja, transmetimi i fotove, filmave apo çdo material tjetër vizual, që paraqet fëmijën duke kryer çdo lloj aktiviteti seksual ose që tregon pjesët gjenitale të fëmijës, për qëllime seksuale ose çdo lloj tjetër përfitimi.

k) “Shitje e fëmijëve” është çdo veprim ose transaksion, me anë të të cilit fëmija transferohet nga një person a grup personash te një tjetër me anë të shpërblimit ose me qëllim të përfitimit material apo çdo lloj përfitimi tjetër. Shitja e fëmijëve përfshin dorëzimin ose pranimin me çfarëdolloj mjeti të një fëmije për qëllime të shfrytëzimit seksual, transferimin e organeve të një fëmije me qëllim përfitimi, si dhe përfshirjen e një fëmije në punë të detyruar.

l) “Neglizhenca e fëmijës” është mosdhënia dhe mospërmbushja e nevojave të fëmijës për strehë, siguri, mbikëqyrje, ushqim, shëndet dhe arsim.

ll) “Organizatë jofitimprurëse” është organizata e krijuar në përputhje me legjislacionin për organizatat jofitimprurëse, që ka si objekt të veprimtarisë së saj, të përcaktuar në statut dhe/ose në aktin e themelimit, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijës.

#### Neni 4

##### **Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet për mbrojtjen e të drejtave:

- a) të fëmijës që ndodhet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- b) të fëmijës me shtetësi shqiptare që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 5

##### **Parime të përgjithshme**

Mbrojtja e të drejtave bëhet duke garantuar:

1. Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjislative.

2. Barazinë dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.

3. Eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.

4. Respektimin e përgjegjësive, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.

5. Krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim.

6. Parimin e respektimit të mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.

## KREU II TË DREJTAT DHE MBROJTJA E FËMIJËS

### Neni 6

#### **E drejta e jetës, e mbijetesës dhe e drejta për zhvillim**

1. Fëmija ka të drejtën e pamohueshme për të jetuar e për të gëzuar mirëqenie dhe kujdes shëndetësor bazë. Fëmijës i garantohet gëzimi i standardeve më të larta të mundshme të shëndetit dhe të trajtimit e të rehabilitimit. Fëmija ka të drejtë të ketë akses te këto shërbime shëndetësore.

2. Prindërit/përfaqësuesit ligjorë kanë përgjegjësi parësore të krijimit të kushteve të jetesës për t'i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijëve të lindur nga martesë dhe jashtë martesë.

### Neni 7

#### **E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe për të ruajtur identitetin**

1. Fëmija, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka të drejtë:

a) të regjistrohet menjëherë me lindjen e tij;

b) të ketë një emër;

c) të fitojë shtetësinë;

ç) të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve aq sa është e mundur.

2. Fëmija ka të drejtë të ruajë identitetin, përfshirë përcaktimin e mbiemrit, fitimin e shtetësisë dhe njohjen e lidhjeve familjare, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa ndërhyrje të paligjshme.

3. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë dhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihe mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për:

a) gjetjen e prindërve;

b) gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijëve refugjatë e azilkërkuës, me qëllim bashkimin familjar;

c) regjistrimin e çdo ndryshimi të identitetit të fëmijës, si emri, shtetësia, të drejtat prindërore.

### Neni 8

#### **E drejta për të qëndruar me prindërit**

1. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të tij.

3. Prindi/përfaqësuesi ligjor nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës.

4. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kërkojë të dhëna të hollësishme për vendin ku ndodhet prindi ose anëtarë i familjes, në rastet kur ata janë të ndaluar, të arrestuar, të burgosur, të internuar, të dëbuar ose kur ata kanë vdekur, për çfarëdo shkak, me përjashtim të rasteve kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e tij.

5. Prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes kanë të drejtë të kërkojnë të dhëna lidhur me vendndodhjen e një fëmije, i cili është ndarë nga prindërit për shkak të ndalimit, burgimit, largimit nga vendi apo të vdekjes gjatë privimit të lirisë, me përjashtim të rastit kur dhënia e këtyre të dhënave dëmton mirëqenien e fëmijës.

#### Neni 9

### **E drejta për ribashkim familjar**

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

2. Në rast se prindërit janë migrantë të paligjshëm në Republikën e Shqipërisë dhe fëmija ka fituar shtetësinë shqiptare, prindërit lejohen të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë e të mos largohen nga vendi.

#### Neni 10

### **E drejta për të siguruar kthimin**

1. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate.

2. Fëmija i pashoqëruar nga prindi/përfaqësuesi ligjor ka të drejtën e kthimit, në një kohë sa më të shpejtë, pranë tyre.

3. Prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës, ose çdo person që merr dizeni për humbjen e tij duhet të njoftojë, brenda 24 orëve, autoritetin shtetëror përgjegjës për të bërë të mundur kthimin e shpejtë dhe të sigurt të fëmijës.

4. Procedurat dhe rregullat për kthimin dhe riatdhesimin e fëmijëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe me marrëveshje ndërkombëtare me vendet e tjera.

#### Neni 11

### **E drejta e shprehjes**

1. Fëmija ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën e pjekurinë e tij.

2. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të marrë dhe për të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik ose të drejtat e të tjerëve.

3. Fëmija ka të drejtë të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, drejtpërdrejt, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor dhe në praninë e detyrueshme të psikologut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Neni 12

### **Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë**

1. Fëmijës i garantohet liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.

2. Prindi/përfaqësuesi ligjor i fëmijës e drejton atë në ushtrimin e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, në përputhje me zhvillimin e aftësitë e tij.

#### Neni 13

### **Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore**

1. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore.
2. Ushtrimi i kësaj lirie bëhet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

#### Neni 14

### **Liria e jetës private**

1. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij.
2. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshi brenda familjes, institucioneve të përkujdesjes shoqërore dhe të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, përfshi të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse.
3. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, përfshi çështjet penale dhe të raportimeve në media.

#### Neni 15

### **E drejta për të marrë informacion**

1. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik dhe psikologjik.
2. Fëmijët duhet të kenë akses në të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për ta.

#### Neni 16

### **E drejta për arsimim**

Fëmija ka të drejtë të arsimohet në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me nivelin e zhvillimit mendor dhe fizik të tij.

#### Neni 17

### **E drejta për pushime dhe argëtime kulturore e sportive**

Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore e artistike, në përshtatje me moshën e tij.

#### Neni 18

### **E drejta për nivel jetese të përshtatshëm**

Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror.

#### Neni 19

### **E drejta për kujdes shëndetësor**

1. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor të përshtatshëm dhe për përfitim nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit.
2. Garantimi i kësaj të drejte bëhet, në veçanti, duke marrë masa:
  - a) për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore;
  - b) për t'i siguruar të gjithë fëmijëve ndihmën e nevojshme mjekësore e kujdesin për shëndetin, duke e vënë theksin në zhvillimin e kujdesit shëndetësor parësor;
  - c) për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

ç) për t'u siguruar nënave kujdesin e duhur shëndetësor, para dhe pas lindjes;

d) për të mundësuar që të gjitha grupet shoqërore dhe, në veçanti, prindërit dhe fëmijët, të marrin informacion, të kenë mundësi edukimi e të përkrahen për të përdorur dijet bazë për shëndetin dhe të ushqyerit e fëmijës, përparësitë e ushqyerjes me gji, higjienën e përmirësimit e mjedisit dhe parandalimin e aksidenteve;

dh) për të zhvilluar kujdesin shëndetësor parandalues, këshillimin e prindërve, edukimin dhe shërbimet në fushën e planifikimit familjar.

#### Neni 20

### **E drejta për mbrojtje sociale**

1. Fëmija ka të drejtë të përfitojë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet prindit/përfaqësuesit ligjor, mbrojtje sociale, përfshirë dhe sigurimet shoqërore.

2. Mbrojtja, kur është e nevojshme, duhet të jepet duke pasur parasysh të ardhurat e kushtet e fëmijës e të personave përgjegjës për mbajtjen e tij, si dhe çdo konsideratë tjetër që lidhet me kërkesën për ndihmë, të bërë nga vetë fëmija ose në emër të tij.

#### Neni 21

### **Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës**

Fëmija mbrohet nga çdo formë e:

- a) dhunës fizike dhe psikologjike;
- b) ndëshkimit trupor dhe trajtimit poshtërues e denigrues;
- c) diskriminimit, përjashtimit dhe fyerjes;
- ç) keqtrajtimit dhe braktisjes;
- d) mospërfilljes dhe neglizhimit;
- dh) shfrytëzimit dhe abuzimit;
- e) dhunës seksuale.

#### Neni 22

### **Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik**

1. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, si dhe nga kryerja e çdo pune që:

- a) paraqet rreziqe;
- b) cenon edukimin;
- c) dëmton shëndetin;
- ç) dëmton zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror;
- d) është e detyruar.

2. Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija nga moshë 14 deri në 18 vjeç mund të punësohet në punë të lehta që nuk dëmtojnë shëndetin dhe formimin e tij, sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

#### Neni 23

### **Mbrojtja nga përdorimi i substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope**

Fëmija mbrohet nga:

- a) përdorimi i substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope;
- b) prodhimi dhe trafiku i paligjshëm i këtyre substancave.

#### Neni 24

### **Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual**

Fëmija mbrohet nga trafikimi, nxitja, si dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e keqtrajtimit seksual, duke iu garantuar mbrojtja nga:

- a) veprimtaria e paligjshme seksuale;



- b) prostitucioni ose nga praktika të tjera seksuale të paligjshme;
- c) shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike;
- ç) shitja e fëmijëve.

#### Neni 25

##### **Mbrojtja nga përfshirja në konfliktet e armatosura**

1. Fëmija nuk lejohet të përfshihet drejtpërdrejt dhe tërthorazi në një konflikt të armatosur.
2. Në rast konflikti të armatosur, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër.
3. Nëse arrestohet ose ndalohet për arsye, që lidhen me konfliktin e armatosur, fëmija do të mbahet në mjedise të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij.

#### Neni 26

##### **Mbrojtja e fëmijës nga tortura, dënimi, trajtimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues**

Fëmija nuk i nënshtrohet torturës, dënimit ose trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

#### Neni 27

##### **Mbrojtja e fëmijës që i është hequr apo kufizuar liria**

1. Fëmijës nuk i mohohet liria në mënyrë të paligjshme dhe arbitrare.
2. Fëmijës, që i është hequr apo kufizuar liria, i sigurohet ndihmë juridike e psikologjike në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit penal, në përputhje me interesat e tij.

#### Neni 28

##### **Ushtrimi i kujdesit prindëror**

1. Prindi/përfaqësuesi ligjor ka detyrimin t'i sigurojë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në këtë ligj.
2. Prindi/përfaqësuesi ligjor, për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore, ka të drejtë t'u kërkojë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës.

#### Neni 29

##### **Përkujdesja alternative**

1. Fëmijës së privuar në mënyrë të përkohshme a të përhershme nga mjedisi i tij familjar ose kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në këtë mjedis, i sigurohet një përkujdesje alternative.
2. Përkujdesja alternative mund të jetë:
  - a) vendosja në një familje birësuese;
  - b) vendosja në një familje alternative ose në një institucion të përkujdesit për fëmijët.
3. Zgjedhja e një prej alternativave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni bëhet në përputhje me:
  - a) procesin e vazhdimësisë së edukimit të fëmijës;
  - b) nivelin e aftësive fizike dhe psikike të fëmijës;
  - c) veçoritë e karakterit dhe të personalitetit të fëmijës, që lidhen me origjinën e tij etnike, fetare, kulturore dhe gjuhësore.
4. Për zgjedhjen për fëmijën, për të cilin/cilën është e pamundur të kujdeset prindi i tij/saj, ndiqet kjo shkallë përparësie:
  - a) vendosja e fëmijës pranë pjesëtarëve të tjerë të familjes së fëmijës, përfshirë këtu edhe anëtarët e familjes në kuptimin e gjerë të konceptit "familje", duke nënkuptuar anëtarët e familjes së zgjeruar;
  - b) nëse zgjedhja, sipas shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni, nuk është e mundur ose nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, fëmija vendoset në një familje alternative;

c) nëse zgjedhja, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij neni, nuk është e mundur ose nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, në alternativë të fundit, fëmija mund të vendoset në një institucion të përkujdesjes sociale.

5. Procedurat që ndiqen për zgjedhjen e një prej alternativave të parashikuara në pikën 2 të këtij neni bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes.

#### Neni 30

### **Fëmija me aftësi të kufizuar**

1. Fëmija me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj, në përputhje me nivelin e zhvillimit të tij.

2. Fëmija me aftësi të kufizuar mendore dhe fizike gëzon përkujdesje të veçantë, e cila jepet falas nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, sa herë të jetë e mundur, duke pasur parasysh burimet financiare të prindit/përfaqësuesit ligjor të tij.

3. Përkujdesi i veçantë përcaktohet për t'i siguruar fëmijës me aftësi të kufizuara qasje efektive në arsimim, trajnim, shërbime të kujdesit shëndetësor, shërbime të rehabilitimit, përgatitje për punësim dhe argëtim, duke zhvilluar mundësitë e tij individuale në mënyrë të favorshme, për arritjen e integritit të plotë të mundshëm social, kulturor dhe shpirtëror.

#### Neni 31

### **Fëmija që i përket pakicave kombëtare**

Fëmija që i përket pakicave kombëtare ushtron të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj, duke shprehur lirisht përkatësinë e tij etnike, kulturore, fetare e gjuhësore.

## KREU III

### MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

#### Neni 32

### **Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**

1. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

2. Mekanizmat në nivel qendror janë:

- a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- b) ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

3. Mekanizmat në nivel vendor janë:

- a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut;
- b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë.

4. Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjisllacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Këta mekanizma bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 33

### **Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës**

1. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është organ këshillimor *ad hoc*, që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

2. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe përbëhet nga 9 përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Përfaqësuesit nga shoqëria civile në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës duhet të jenë shtetas shqiptarë, të cilët të kenë njohuri dhe të kenë marrë pjesë në veprimtari të shquara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës përzgjedh, me një procedurë konkurrimi të hapur, përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe ia propozon Kryeministrit për anëtarë të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

4. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të Këshillit në të njëjtën kohë ndalohej.

5. Rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës e të komiteteve teknike këshilluese të tij përcaktohen në rregulloren e këtij Këshilli, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 34

### **Detyrat e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës**

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka këto detyra:

a) bashkërendon politikat shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shoqërore, arsimore, shëndetësore dhe kulturore;

b) i propozon ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës programet kryesore shtetërore për të drejtat e mbrojtjen e fëmijës dhe drejtimin e politikave shtetërore për përmirësimin e gjendjes së trajtimit të tyre;

c) vlerëson gjendjen konkrete të respektimit të të drejtave të fëmijës në Shqipëri, duke nxjerrë udhëzime dhe duke dhënë rekomandime të posaçme për Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe autoritetet e tjera shtetërore, përgjegjëse në fushat përkatëse;

ç) analizon zbatimin e politikave shtetërore dhe të programeve kombëtare e rajonale për mbrojtjen e fëmijës;

d) rekomandon shërbime dhe programe që janë specifikuara të orientuara për fëmijët dhe familjet e tyre, kryesisht të atyre që kanë nevojë për mbrojtje emergjente;

dh) bën propozime dhe jep rekomandime për përmirësimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

#### Neni 35

### **Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës**

1. Ministri që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse që ka për këtë qëllim:

a) harton politika dhe programe shtetërore në fushën e mbrojtjes së fëmijës;

b) mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit për fëmijët, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së fëmijës;

c) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së fëmijës, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera për garantimin e të drejtave të tyre, kryesisht, dhe në bazë të rekomandimeve të propozuara nga Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;

ç) bashkërendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës;

d) kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës dhe miraton raportin vjetor të saj për ecurinë e realizimit të mbrojtjes së fëmijës;

dh) nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e njësive të të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;

e) orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët;

ë) ofron mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr.10 093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”;

f) bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

3. Mekanizmi i bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyra e procedimit të tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 36

### **Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës**

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është person juridik, në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, financuar nga fondet e Buxhetit të Shtetit dhe donatorë të ndryshëm.

2. Agjencia drejtohet dhe përfaqësohet nga kryetari, i cili emërohet nga Kryeministri, me propozim të ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, pas përfundimit të një procesi konkurrimi të hapur.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen nga Kryeministri, me propozim të ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës.

4. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës përcaktohen në rregulloren e Agjencisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 37

### **Detyrat e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës**

1. Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka këto detyra:

a) të monitorojë dhe të kontrollojë zbatimin e këtij ligji, të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit të saj, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe të legjislacionit në fuqi në këtë fushë;

b) t'i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës propozime për politika dhe ndryshime ligjore e nënligjore në fushën e të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës;

c) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijëve udhëzime metodologjike për njësitë e të drejtave e të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore;

ç) të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

d) t'i japë mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

dh) të bashkërendojë punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të ministrit që mbulon çështjet e mbrojtjes së fëmijës;

e) të organizojë dhe të bashkërendojë kërkimet shkencore dhe veprimtaritë informuese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

ë) të ndërtojë dhe të realizojë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve e të funksionarëve të administratës publike e të sistemit gjyqësor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera;

f) të ndërtojë mekanizmat e mbledhjes së statistikave, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe të mbikëqyrë mbledhjen dhe përpunimin e tyre;

g) të unifikojë të dhënat statistikore për çështjet që lidhen me fëmijët, në bashkëpunim me mekanizmat institucionalë në nivel vendor për mbledhjen dhe përpunimin e përgjithshëm të tyre;

gj) të realizojë mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e informacionit për promovimin e respektimit të mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

h) t'i paraqesë ministrit që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, brenda tremujorit të parë të çdo viti, raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, për ecurinë e punës, problemet e hasura dhe për rrugët për kapërcimin e tyre, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

i) të zhvillojë dhe të mirëmbajë sistemin e informacionit për:

- institucionet e specializuara për fëmijët dhe personat e kontaktit;
- organizatat jofitimprurëse që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- të dhëna të tjera që lidhen me mbrojtjen e fëmijës;

j) të koordinojë burimet e ndryshme të autoriteteve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve;

k) të vendosë gjohë ndaj shkelësve të ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 40 të këtij ligji.

l) të bashkërendojë veprimtarinë e saj me agjencitë homologe në vendet e tjera.

2. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me Agjencinë, për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të të dhënave të tjera të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

3. Llojet, mënyra e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit dhe të të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia e nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Procedurat e kryerjes së kontrollit dhe të vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, ndaj shkelësve të të drejtave të fëmijëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 38

#### **Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut**

1. Njësia për të drejtat e fëmijës, që funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale, ka për detyrë:

a) të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

b) të identifikojë dhe të koordinojë referimin e rasteve të shkeljeve apo të abuzimit, të keqpërdorimit të të drejtave të fëmijëve në territorin e qarkut;

c) të koordinojë funksionimin e grupit multidisiplinar, për identifikimin, analizën dhe referimin e rasteve të dhunës në familje në territorin e qarkut;

ç) të bashkëpunojë dhe të shkëmbejë informacionin për trajtimin e të drejtave të fëmijës me çdo strukturë përgjegjëse shëndetësore, arsimore, policore, të qeverisjes vendore, në bashki dhe komuna, apo të shoqërisë civile;

d) të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për të drejtat e fëmijës në qark;

dh) t'i raportojë këshillit të qarkut për ecurinë e respektimit të të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut;

e) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar, për gjendjen e të drejtave të fëmijës në qark;

ë) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e zbatimit të të drejtave të fëmijës në qark.

2. Pranë këshillit të qarkut krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e qarkut.

#### Neni 39

#### **Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë**

1. Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë/komunës, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë:

a) të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet "jo në rrezik";

b) të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë multidisiplinare, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë/komunës;

c) të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukuese dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

ç) të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e shkollave, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

d) të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë/komunës mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;

dh) t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë/komunës;

e) t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë/komunës.

2. Pranë bashkisë/komunës krijohen grupet multidisiplinare për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë/komunës.

3. Në njësinë për mbrojtjen e fëmijës në bashki/komunë të ketë, të paktën, një punonjës me formim në fushën e punës sociale.

#### KREU IV SANKSIONET ADMINISTRATIVE

##### Neni 40 **Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 7, 8, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 21 dhe 26 të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht:

a) personi fizik, nga 30 000 deri në 60 000 lekë;

b) personi juridik nga 60 000 deri në 120 000 lekë;

c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri në 80 000 lekë;

ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 30 000 deri në 80 000 lekë.

2. Procedura për shqyrtimin e kundërvajtjeve administrative dhe ekzekutimin e gjobave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

##### Neni 41 **Ankimi**

Kundërvajtësi, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vënien e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

#### KREU V DISPOZITA TË FUNDIT

##### Neni 42 **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10 pika 4, nenit 32 pikat 4 e 5, nenit 33 pika 5, nenit 35 pika 3, nenit 36 pika 4 dhe nenit 37 pikat 3 e 4 të këtij ligji.

Neni 43  
**Shfuqizime**

Aktet ligjore dhe nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 44  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6771, datë 15.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**LIGJ**  
**Nr.10 350, datë 11.11.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9323, DATË 25.11.2004 “PËR  
BARNAT DHE SHËRBIMIN FARMACEUTIK”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 3 “Përkufizime” shtohen pikat 30 dhe 31 me këtë përmbajtje:

“30. “Farmakovigjilenca” është shkenca dhe veprimtaria që merret me zbulimin, evidentimin dhe vlerësimin e efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave, për parandalimin e mundshëm të tyre, si dhe çdo problem që lidhet me sigurinë dhe efikasitetin e barnave.

31. “Mbajtësi i autorizimit të tregtimit” është personi juridik, në emër të të cilit është lëshuar certifikata e regjistrimit të barit të gatshëm për përdorim. Ky subjekt është përgjegjës për cilësinë, sigurinë dhe efikasitetin e barit të gatshëm për përdorim, në përputhje me informacionin e deklaruar për regjistrim.”.

**Neni 2**

Në nenin 13, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Aplikimi dhe praktika e regjistrimit të barnave bëhet në QKKB nga prodhuesit vendas, të licencuar, dhe nga mbajtësi i autorizimit për tregtim, edhe kur ky nuk është prodhues i barit, sipas rregullave të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.”.

**Neni 3**

Pas kreut IV shtohet kreu IV/1 me këtë përmbajtje:

“KREU IV/1  
FARMAKOVIGJILENCA

Neni 21/1

**Mënyra e organizimit të farmakovigjilencës**

1. Qendra e Farmakovigjilencës (QF) është përgjegjëse për zbulimin, mbledhjen, evidentimin dhe vlerësimin e efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barnave për përdorim në njerëz.
2. Profesionistët e shëndetësisë (mjekë, stomatologë, farmacistë dhe infermierë) dhe përdoruesit e barnave raportojnë për çdo efekt të padëshiruar, që lidhet me barnat, pranë Qendrës së Farmakovigjilencës.
3. Të gjitha efektet e padëshiruara dhe/ose të dëmshme, të vërejtura gjatë studimeve klinike me barnat, raportohen në QF.
4. Informacioni për efektet e padëshiruara të barnave është konfidencial. Publikimi ose dhënia e tij lejohet vetëm me miratim të QF-së. Në këtë rast ai duhet të jetë objektiv e të mos shkaktojë keqkuptime.
5. Mënyra e raportimit, e mbledhjes dhe e vlerësimit të efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme të barit përcaktohet me rregullore, të miratuar me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
6. Organizimi dhe funksionimi i QF-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21/2

**Përgjegjësitë e mbajtësit të autorizimit për tregtim**

Mbajtësit e autorizimit për tregtim janë përgjegjës për:

1. Mbajtjen e të dhënave të detajuara për të gjitha efektet e padëshiruara dhe/ose të dëmshme, të dyshuara, në Republikën e Shqipërisë dhe në vendet e tjera ku tregtohet bari.
2. Raportimin e menjëhershëm të të gjitha dyshimeve për efektet e padëshiruara dhe/ose të dëmshme, serioze, të raportuara tek ai nga profesionistët e shëndetit.
3. Raportimin e të gjitha efekteve të padëshiruara dhe/ose të dëmshme, të papritura dhe serioze, të ndodhura në vende të tjera ku qarkullon bari.
4. Emërimin e një personi përgjegjës (mjek, farmacist, stomatolog) për farmakovigjilencën, i cili deklarohet zyrtarisht që në çastin e aplikimit për regjistrim të barit.
5. Dorëzimin e raporteve periodike për sigurinë e barit pranë QF-së.”.

Neni 4

Në nenin 30, pika 2 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenet 18 dhe 47 pika 1, fjalët “mbajtës të licencës së tregtimit” zëvendësohen me fjalët “mbajtës i autorizimit të tregtimit”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6782, datë 23.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**



**LIGJ**  
**Nr.10 351, datë 11.11.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.10 033, DATË 11.12.2008**  
**“PËR LOJËRAT E FATIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 8 pika 2, në fund të fjalisë së parë shtohen fjalët “dhe i licencuari për lotari kombëtare, në përputhje me pikën 2 të nenit 26 të këtij ligji”.

**Neni 2**

Në nenin 9, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Subjekti i licencuar për lotarinë kombëtare lejohet që, në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në bazë të rregullave të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe të marrëveshjes së nënshkruar me Ministrin e Financave, të bëjë publicitet në lidhje me lojërat e ofruara nga lotaria kombëtare dhe të hartojë e të shpërndajë buletine informative, si dhe të bëjë reklama e njoftime në median e shkruar dhe audiovizive.”.

**Neni 3**

Në nenin 10 pika 4, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) për hapjen e çdo salle të re, ku do të zhvillohet veprimtaria, organizatori njofton, paraprakisht, NJMLF-në, për të marrë miratimin dhe për t'u pajisur me NIPT-in sekondar, i cili lëshohet për çdo vendndodhje dytësore të biznesit.”.

**Neni 4**

Në nenin 10, pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Këshilli i Ministrave, me vendim, miraton rregullat, procedurat, afatet dhe specifikimet teknike të mekanizmave të fiskalizimit e të monitorimit të lojërave të fatit.”.

**Neni 5**

Në nenin 13 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Shkronja “dh” e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

“dh) në rakordim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe me drejtoritë rajonale të administratës tatimore qendrore, verifikon shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe deklarimet mujore të organizatorëve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 50 të këtij ligji.”.

b) Pas shkronjës “dh” të pikës 1 shtohen shkronjat “e” dhe “ë” me këtë përmbajtje:

“e) kontrollon e verifikon deklarimet e bëra nga organizatorët pranë NJMLF-së, në përputhje me detyrimet për deklarim, të parashikuara nga ky ligj;

ë) kontrollon dhe verifikon fitimet nga lojërat.”.

c) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Shtypja dhe prodhimi i biletave, lëshimi i biletës *on line* apo forma të tjera të pranimit të pjesëmarrjes në lojë, nëpërmjet shërbimit të telefonisë celulare, bëhen në përputhje me procedurat, afatet dhe formatet e miratuara me udhëzim të Ministrit të Financave, sipas llojit të lojës për të cilën do të përdoren.”.

#### Neni 6

Në nenin 23 pika 1, pas shkronjës “g” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) të dorëzojë dokumentacionin që vërteton se ka në pronësi apo në përdorim sipërfaqen në të cilën ushtron veprimtarinë.”.

#### Neni 7

Në nenin 24 pika 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) makinat elektronike duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe të certifikuara në përputhje me nenin 25 të këtij ligji. Afati i përfundimit të procesit të zëvendësimit të makinave elektronike ekzistuese me ato që plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë shkronjë miratohet me urdhër të Ministrit të Financave.”.

#### Neni 8

Në nenin 26 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, pas fjalisë së parë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Licenca/kontrata bëhet efektive pas miratimit nga Kuvendi.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Licenca e lotarisë kombëtare përfshin:

a) të gjitha lojërat numerike, ku numrat tërhiqen nga një radhë e paracaktuar numrash e në të cilat përcaktohen:

i) loja “loto”, që është lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon baste për shansin e fitimit të disa numrave nga një seri e paracaktuar numrash. Numrat fitues përcaktohen me hedhje publike të shortit. Shuma e përgjithshme e çmimeve të fitueshme ndahet në disa kategori fitimi, ku brenda secilës kategori të gjitha fitimet janë të barabarta;

ii) “loja shtesë”, që është një lojë fati, e cila mund të zhvillohet vetëm në lidhje me lojërat e tjera, që lejohen të organizohen nga i licencuari. Numri fitues përcaktohet me hedhje publike të shortit. Fitojnë ata lojtarë, numri i biletës së të cilëve përputhet plotësisht ose pjesërisht me numrin fitues. Shuma e përgjithshme e çmimeve të fitueshme ndahet në disa kategori fitimi. Brenda secilës kategori të gjitha fitimet janë të barabarta;

b) lojën “keno”, që është një lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon lojën lidhur me shanset e fitimit të kombinimeve të numrave, ku lojtarët fitojnë nëpërmjet përputhjes së kombinimeve përkatëse të numrave me numrat fitues të përcaktuar;

c) lojën “loto me shifra”, që është një lojë fati, në të cilën organizatori pranon dhe zhvillon lojën për shansin e fitimit të një ose më shumë numrave ose simboleve, nga një sasi të përcaktuar numrash a simbolesh. Numrat ose simbolet fituese përcaktohen me hedhje publike të shortit. Çmimi fitues individual është një shumëfish i paracaktuar i bastit të vënë në lojë ose shuma e çmimit ndahet në disa kategori fitimi. Të gjitha fitimet e secilës kategori janë të barabarta;

ç) lotaritë që mund të jenë:

i) “lotaritë e çastit”, që janë lojëra fati, në të cilat pjesëmarrësi i lojës mund të konstatojë menjëherë nëse ka fituar, duke kontrolluar a është printuar një çmim fitues në biletën e tij. Lojëra të tjera të çastit janë lojëra fati, në të cilat pjesëmarrësit e lojës mund të marrin dijëni për një fitim të mundshëm brenda 24 orëve pas mbarimit të bastit për shanset e fitimit të simboleve dhe kombinimeve të numrave;

ii) “lotaritë e numrave”, që janë lojëra fati, në të cilat çdo biletë e lotarisë ka një numër vijues të shënuar në të. Biletat fituese përcaktohen me hedhje publike të shortit;

iii) “lotaritë elektronike”, që janë lotari, në të cilat kontrata e lojës lidhet nëpërmjet mediave elektronike, vendimi mbi fitimin apo humbjen merret ose vihet në dispozicion në një mënyrë qendrore dhe pjesëmarrësi i lojës mund të marrë dijëni për rezultatin e këtij vendimi menjëherë pas pjesëmarrjes në lojë.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Organizatori i lotarisë kombëtare organizon të gjitha apo një pjesë të lojërave të lotarisë kombëtare. Organizimi i lojërave bëhet nëpërmjet shitjes me pakicë të biletave, nëpërmjet rrjetit on line, internetit apo përdorimit të shërbimit të telefonisë celulare. Organizatori i lotarisë kombëtare njofton NJMLF-në për:

a) të gjitha lojërat e ofruara, sapo të jetë marrë vendimi që ato të hidhen në treg nga organi i të licencuarit;

b) çdo ndryshim të rëndësishëm të çdo loje, sapo të jetë marrë vendimi për ndryshimin nga organi i të licencuarit;

c) adresat, në të cilat ushtron veprimtarinë për lojërat e lotarisë kombëtare.”.

#### Neni 9

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” të pikës 2, fjalët “shoqëri aksionare apo bashkim shoqërish” zëvendësohen me fjalët “shoqëri tregtare, tregtar apo bashkim shoqërish”.

2. Në shkronjat “a” dhe “ç” të pikës 3, fjala “aksionarët” zëvendësohet me fjalën “ortakët”, si dhe në shkronjën “c” fjala “aksionarëve” zëvendësohet me fjalën “ortakëve”.

#### Neni 10

Titulli i nenit 34 ndryshohet si më poshtë:

“Procedurat për licencimin e kazinove”.

#### Neni 11

Në nenin 41, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rast të aplikimit për bingo televizive, përveç dokumentacionit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, në NJMFL paraqiten edhe:

a) marrëveshja ndërmjet organizatorit të lojës dhe agjentëve për shitjen e biletave;

b) marrëveshja ndërmjet organizatorit të lojës dhe operatorit apo operatorëve të telefonisë celulare;

c) marrëveshja për transmetimin e lojës (shorteut) për bingo televizive, e lidhur ndërmjet organizatorit dhe një stacioni televiziv kombëtar;

ç) strategjia për informimin e klientëve për rregullat e kësaj loje, ku duhet të përcaktohen data e hedhjes së shortit, mënyra e luajtjes, vendi ku do të tërhiqen çmimet, të dhënat për vendin ku do të bëhet transmetimi dhe nxjerrja e rezultateve;

d) rregullorja e lojës dhe fondi për fituesin, i cili, për çdo lojë, nuk mund të jetë më i vogël se 50 për qind e shumës nga vlera e arkëtuar nga shitja e biletave dhe nga prenotimi nëpërmjet telefonisë celulare.”.

#### Neni 12

Në nenin 44 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Në fjalinë e parë të pikës 5.2, fjalët “5 për qind mbi vëllimin e qarkullimit, gjithsej, të realizuar në bazë të arkëtimeve nga shitja e biletave” zëvendësohen me fjalët “25 për qind mbi fitimin nga loja”.

3. Në pikën 5.2 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 0,2 për qind të shumave të grumbulluara, në përputhje me këtë nen, për zhvillimin e sporteve.”.

#### Neni 13

Në nenin 45, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të bashkisë apo komunës ku zhvillon veprimtarinë për kazino 0,2 për qind të xhiros.”.

#### Neni 14

Në nenin 46, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Brenda datës 10 të muajit pasardhës, organizatori i lojërave të fatit derdh në llogari të bashkisë apo komunës ku zhvillon veprimtarinë për baste me gara në pistë 0,2 për qind të xhiros.”.

#### Neni 15

Në nenin 47, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Pajisjet, që shërbejnë për lojëra fati, të cilat gjenden nga NJMLF-ja në mjedise të padeklaruara pranë kësaj njësie, konfiskohen. Nëse është e pamundur që pronari të identifikohet, kjo e dhënë shënohet në aktin administrativ të konfiskimit.”.

#### Neni 16

Në nenin 49, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, një herë në tre muaj, informon NJMLF-në për rastet e zhdoganimit të pajisjeve që shërbejnë për lojëra fati.”.

#### Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6783, datë 23.11.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

### **VENDIM**

**Nr.853, datë 21.10.2010**

### **PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR SARANDË-KRANE-KONISPOL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, dat 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Sarandë-Krane-Konispol.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelat bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 12 190 (dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) m<sup>2</sup>, tokë arë, me vlerë 1 695 036.8 (një milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e tridhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë, për sipërfaqen truell 338 (treqind e tridhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, me vlerë 289 950 (dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) lekë, për sipërfaqen kullotë 37 283 (tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) m<sup>2</sup>, me vlerë 2 042 053.3 (dy milionë e dyzet e dy mijë e pesëdhjetë e tre pikë tre) lekë, për dru frutorë, me vlerë 1 443 946 (një milion e katërqind e dyzet

e tre mijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë) lekë, për objekt, me vlerë 4 556 233 (katër milionë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e tre) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 10 027 219.1 (dhjetë milionë e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë pikë një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 420 000 (katërqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 10 027 219.1 (dhjetë milionë e njëzet e shtatë mijë e dyqind e nëntëmbëdhjetë pikë një) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave, pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.11.2010 dhe të përfundojë më 1.2.2011.

7. Pronarët e përmendur në listat, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Pronarët e përmendur në listat, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit të pasurisë, e cila shpronësohet dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, në përputhje me dokumentacionin e pronësisë.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja sipas të dhënave të regjistrimit hipotekor”, pasi të kenë përfunduar procedurat e regjistrimit të pasurisë, e cila shpronësohet, dhe në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë.

11. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit jo vetëm për pasuritë e pasqyruara në listat bashkëlidhur këtij vendimi, por edhe për pasuritë e shpronësuara me vendimin nr.1682, datë 24.12.2008 të Këshillit të Ministrave.

12. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

13. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
 Qarku: VLORË  
 Bashkia: Sarandë, fshati: Gjashtë

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”  
 Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë, arë, truall

Nr.	PRONAR			Toke Arë				Truall			Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i pasurisë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë		
1	Bashkëpronësi			918	729	146	106434				106434	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Frederik	Maze	Maze	1097				38	1425	54150	54150	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Bashkëpronësi			628/6	115	146	16790				16790	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Bashkëpronësi			360/1	250	146	36500				36500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
					<b>1094</b>		<b>159724</b>	<b>38</b>		<b>54150</b>	<b>213874</b>	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
 Qarku: VLORË  
 Bashkia: Konispol, fshati:Konispol, nr. rendor 1-28

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë, arë, kullotë

Nr.	Pronari			Toke arë				Kullotë			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i pasurisë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë		
1	Trashëgim	Idriz	Arapi	17	1266	134.3	170024				170023.8	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Fezane	Selfo	Arapi	25	593	134.3	79639.9				79639.9	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Rexhep	Braho	Taka	44	329	134.3	44184.7				44184.7	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Ramadan	Adem	Mehmeti	70	878	134.3	117915				117915.4	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Ibrahim	Veysel	Kamberi	75	648	134.3	87026.4				87026.4	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Sami	Abedin	Arapi	1474	600	134.3	80580				80580	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Bashkim	Shahin	Braho	1441	700	134.3	94010				94010	Konfirmuar nga ZRPP-ja
8	Luan	Nuredin	Besho	1436	228	134.3	30620.4				30620.4	Konfirmuar nga ZRPP-ja
9	Fejzo	Isuf	Dishati	1418	164	134.3	22025.2				22025.2	Konfirmuar nga ZRPP-ja
10	Hekuran	Safet	Çokalli	1218	1550	134.3	208165				208165	Konfirmuar nga ZRPP-ja
11	Hekuran	Safet	Çokalli	1202	630	134.3	84609				84609	Konfirmuar nga ZRPP-ja
12	Enver	Refat	Çokalli	1240	1100	134.3	147730				147730	Konfirmuar nga ZRPP-ja
13	Sefedin	Qerim	Veshi	1228	500	134.3	67150				67150	Konfirmuar nga ZRPP-ja
14	Sazan	Hajri	Mane	1239	500	134.3	67150				67150	Konfirmuar nga ZRPP-ja
15	Fiqiri	Kaso	Kaso	1266	470	134.3	63121				63121	Konfirmuar nga ZRPP-ja
16	Trashëgimtarët e Alush Takës			3409				4276	52	222352	222352	Konfirmuar nga ZRPP-ja
17	Trashëgimtarët e Alush Takës			3410				4596	52	238992	238992	Konfirmuar nga ZRPP-ja
18	Trashëgimtarët e Alush Takës			2577/1				482	52	25064	25064	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		<b>TOTALI</b>			<b>10156</b>		<b>1363950.8</b>	<b>9354</b>		<b>486408</b>	<b>1850358.8</b>	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
 Qarku: VLORE  
 KOMUNA: Markat, fshati Shalës

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”  
 Lloji i pasurisë së paluajtshme: kullotë

Nr.	PRONAR			Kullotë			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	
1	Trashëgimtarët e Safet Abdi			27929	55.7	1555645.3	Konfirmuar nga ZRPP-ja, sipas të dhënave të regjistrit hipotekor
		<b>TOTALI</b>		<b>27929</b>		<b>1555645.3</b>	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE  
 Qarku: VLORE  
 Komuna: Finiq, fshatrat: Vrion, Çlirim

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”  
 Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë arë, truall

Nr.	PRONAR			Toke arë				Truall			Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.i pasurisë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë	Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi m <sup>2</sup>	Vlera në lekë		
1	Harallamb	Koci	Papa	1467/1	78	182	14219				14219.4	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Ilia	Stiliano	Babi	1457	347	182	63258				63258.1	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Andrea	Mihal	Totoshi	1452	515	182	93885				93884.5	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Sotir	Spiro	Thanasi	897				300	786	235800	235800	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		<b>TOTALI</b>			<b>940</b>		<b>171362</b>	<b>300</b>		<b>235800</b>	<b>407162</b>	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”  
 Lloji i pasurisë: objekte

		<b>Pronari</b>			<b>Objekt</b>		<b>Vlera totale</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Nr.i pasurisë</b>	<b>Lloji</b>	<b>Qyteti/fshati</b>	<b>Lekë</b>	<b>Shënime</b>
1	Sotir	Spiro	Thanasi	897	Lokal	Çlirim	4556233	Konfirmuar nga ZRPP-ja
		<b>TOTALI</b>					<b>4556233</b>	

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT  
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “SARANDË KRANE KONISPOL”  
 Lloji i pasurisë: kultura dru-frutorë

		<b>Pronari</b>			<b>Ullinj</b>			<b>Hardhi</b>	<b>Portokalle</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emri</b>	<b>Atësia</b>	<b>Mbiemri</b>	<b>Nr.i pasurisë</b>	<b>Nr. rrënjëve</b>	<b>Vlera lekë</b>	<b>Nr. rrënjëve</b>	<b>Vlera lekë</b>	<b>Nr. rrënjëve</b>	<b>Vlera lekë</b>	<b>Vlera totale lekë</b>	<b>Shënime</b>
1	Bashkëpronësi			917	19	226000					226000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Bashkëpronësi			1006	10	119000					119000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
3	Bashkëpronësi			818	6	71400					71400	Konfirmuar nga ZRPP-ja
4	Hekuran	Safet	Çokalli	1218	11	106000					106000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
5	Enver	Refat	Çokalli	1240	4	38400					38400	Konfirmuar nga ZRPP-ja
6	Sefedin	Qerim	Veshi	1228	2	19600					19600	Konfirmuar nga ZRPP-ja
7	Sazan	Hajri	Mane	1239	10	48500					48500	Konfirmuar nga ZRPP-ja
8	Figri	Kaso	Kaso	1266	5	24250					24250	Konfirmuar nga ZRPP-ja
9	Daut		Brinja	117	3	28800					28800	Konfirmuar nga ZRPP-ja
10	Bashkëpronësi			628/6	25	240000					240000	Konfirmuar nga ZRPP-ja
11	Bashkëpronësi			918	12	115200					115200	Konfirmuar nga ZRPP-ja
12	Resul		Balliu	139/3			6	2700			2700	Konfirmuar nga ZRPP-ja
13	Spiro	Mico	Grema	318/2					5	37720	37720	Konfirmuar nga ZRPP-ja
14	Vangjel		Fundo	120/1					4	30176	30176	Konfirmuar nga ZRPP-ja
15	Bashkëpronësi			531					50	336200	336200	Konfirmuar nga ZRPP
		<b>TOTALI</b>			<b>107</b>	<b>1037150</b>	<b>6</b>	<b>2700</b>	<b>59</b>	<b>404096</b>	<b>1443946</b>	

**UDHËZIM**  
**Nr.33, datë 1.11.2010**

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE PËR LICENCË TË  
INSTITUCIONEVE ARSIMORE PRIVATE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE  
PLOTËSUESE PRIVATE PARAUNIVERSITARE**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.358, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar

**UDHËZOJ:**

**KREU I**  
**KRITERET PËR DHËNIEN E LICENCËS**

1. Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat (DZHAP), shqyrton paraprakisht dokumentacionin e subjektit (person juridik) që aplikon për licencë, të dërguar në mënyrë elektronike (*on line*) nëpërmjet regjistrimit aplikativ nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL). Në rast se gjatë shqyrtimit paraprak, DZHAP vë re se ka mangësi në dokumentacion, i propozon Ministrit të Arsimit dhe Shkencës refuzimin e kërkesës.

2. Shqyrtimi i dokumentacionit bëhet në përputhje me kriteret e posaçme të licencimit, si dhe llojet e dokumenteve provuese shoqëruese përkatëse, të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

3. Kërkesa do të konsiderohet e plotë, nëse përmban dokumentacionin në vijim:

i) Deklaratën e subjektit për:

a) numrin dhe datën e ekstraktit historik të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) për regjistrimin si person juridik, me aktivitet në fushën e arsimit privat të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

b) numrin dhe datën e lejes higjieno-sanitare të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

c) numrin dhe datën e vërtetimit nga njësi e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

d) datën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe kohëzgjatjen e saj (jo më pak se 5 (pesë) vjet) dhe/ose datën e dokumentit të pronësisë, (kopje të njëzuar me origjinalin) të nxjerrë jo më herët se tre muaj nga data e depozitimit të kërkesës. Deklarata të shoqërohet me dokumentet përkatëse;

e) datën e nxjerrjes dhe kohëzgjatjen e lejes së qëndrimit dhe lejes së punës për shtetasit e huaj të lëshuar jo më parë se tre muaj që nga data e depozitimit të kërkesës;

f) deklaratën e subjektit që nuk është në ndjekje penale nga organi i prokurorisë, proces gjyqësor, proces hetimi;

g) deklaratën e subjektit që ka të ardhura të mjaftueshme për të ushtruar aktivitetin, për të cilin kërkon të licencohet;

h) numrin e identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT);

ii) dokumentacionin teknik të mëposhtëm:

a) Deklaratë për emërtimin e institucionit, numrin e telefonit personal dhe të institucionit, adresën e postës elektronike, nivelin e arsimimit që do të ofrojë, numrin e grupeve apo të klasave që do të formohen, numrin e fëmijëve/nxënësve për grup/klasë dhe për shkollat, titullin e dokumentit që do të lëshohet në përfundim të çdo viti shkollor, apo kursi;

b) Deklaratë për shërbimet që do të ofrohen në këtë institucion dhe për tarifën përkundrejt së cilës ofrohen shërbimet e deklaruar;

c) Plani mësimor dhe programet lëndore që do të zbatojë institucioni;

d) Lista e teksteve që do të përdoren: në lëndët mësimore të detyruara sipas aletertekstit (për vitin shkollor përkatës), apo në lëndët mësimore shtesë, me zgjedhje apo fakultative;

e) Lista e plotë e stafit drejtues, mësime dhe ndihmës ku duhet të përfshihet edhe administratori, e shoqëruar me deklaratën e subjektit për arsimimin përkatës të stafit si dhe për ngarkesën mësimore të tij;

f) Deklaratën për inventarin faktik të bazës materiale dhe asaj didaktike që mendohet të vihet në dispozicion dhe që është në funksion të arsimit, edukimit dhe realizimit të kërkesave të programeve lëndore për të provuar se mjetet mësimore janë të mjaftueshme për të realizuar kërkesat e planit mësimor dhe të programeve lëndore.

4. Verifikimi i përmbushjes së standardeve normative të infrastrukturës të objektit shkollor realizohet nga një person juridik apo fizik i licencuar pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari në ndërtim”. Subjekti i licencuar kontrollon, nëse aplikuesi disponon lejen higjieno-sanitare dhe vërtetimin nga njësia e pushtetit vendor për mbrojtjen kundër zjarrit. Personi fizik ose juridik i licencuar përgatit një relacion, i cili i bashkëlidhet dokumentacionit të aplikimit.

5. Standardet normative që duhet të përmbushë/in objekti/et që do të funksionojnë si institucione arsimore janë:

a) Klasë e zakonshme konsiderohet ai mjedis mësimor që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi rej 1.3-1.6 m<sup>2</sup>/nxënës;

b) Nyjet hidrosanitare përfshijnë 1 boks për 40 djem, 1 boks për 30 vajza, si dhe 1 boks për administratën.

c) Për kopshtet, shërbimet higjienike vendosen pranë çdo grupi dhe pozicionohen në mënyrë të tillë që të jenë sa më afër për secilin grup. Numri i bokseve duhet të jetë 3 (tri) për një grup, duke i ndarë me mure nga njëri-tjetri dhe duhet të ketë dhe katër lavamanë me ujë të pijshëm. Banjat duhet të kenë porta të hapshme nga jashtë dhe të shkëputura nga dyshemeja. Të përjashtohet hapja e dyerve nga brenda për lehtësimin e daljes në raste emergjence. Pajisjet e banjave duhet të jenë të përshtatshme për moshën e fëmijëve.

d) Për edukimin fizik, subjekti që kërkon licencë duhet të ketë në dispozicion një palestër (për shkollat nën 100 nxënës shfrytëzohet një klasë në katin përdhe me përmasa 60 m<sup>2</sup>) dhe një kënd sportiv jo më të vogël se 100 m<sup>2</sup>.

e) Objektet arsimore që vihen në dispozicion për nivele të ndryshme arsimimi (kopshte, shkollë 9-vjeçare dhe shkollë e mesme) të kenë mjedise që nuk komunikojnë me njëri-tjetrin.

f) Lidhur me normativën e ndriçimit natyral duhet që sipërfaqja e dritareve të mbulojë minimalisht 15% të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi duhet të jetë në krahun e majtë të nxënësit, mundësisht i orientuar nga juglindja. Ndriçimi të realizohet me dritare me xham të tejdukshëm. Dritaret nuk lejohet të vendosen në murin ku është vendosur dërrasa e zezë.

g) Për shkollat e arsimit bazë (sistemi 9-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 9 klasa për ciklin e ulët dhe të lartë dhe dy dhoma mësuesish. Për shkollat e ciklit të ulët (5-vjeçar) duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 klasa dhe një dhomë mësuesish. Për shkollat e mesme të përgjithshme/profesionale duhet të jenë në dispozicion, minimumi, 5 dhoma mësimore. Për kopshtet të ketë minimalisht 3 dhoma mësimore.

h) Objektet arsimore me mbi 200 nxënës duhet të jenë të pajisura me dalje dhe shkallë emergjence.

i) Objektet arsimore duhet të jenë të pajisura me pikën e ndihmës së shpejtë dhe pajisjet e nevojshme në të.

j) Objektet arsimore duhet të kenë sistemin e mbrojtjes kundër zjarrit.

k) Objektet arsimore të jenë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore dhe të plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për nxënësit duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Materialet e përdorura për ndërtimin e tyre nuk duhet të kenë elemente përbërëse të dëmshme për shëndetin e nxënësve.

Këto materiale duhet të sigurojnë akustikë të mirë në mjedisin e mësimit dhe të jenë izoluese ndaj zhurmave dhe luhatjeve të temperaturës.

l) Objektet arsimore duhet të kenë larg zonave industriale, varrezave apo zonave me ndotjes mbi normat e lejuara.

m) Objektet arsimore të jenë të pajisura me gjenerator dhe depozitë uji.

n) Objektet arsimore të kenë sistem ngrohjeje.

6. Në rast se dokumentacioni i mësipërm rezultoi i plotë, Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat vlerëson rregullsinë e dokumentacionit ligjor dhe përputhshmërinë e planit mësimor dhe programeve lëndore me ato të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) që do të zbatohet institucioni, listën e teksteve që do të përdoren, si dhe miraton apo refuzon kërkesën për licencë.

7. Në përfundim të shqyrtimit të dosjes, DZHAP-ja del me një vendim miratues ose mosmiratues, duke respektuar kërkesat e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

a) Vendimi miratues duhet të përcaktojë edhe kufizimet apo detyrimet specifike, nëse është rasti, si dhe arsyetimin ligjor për to.

b) Në rastin e vendimit mosmiratues, ai duhet të përcaktojë qartë shkaqet e mosmiratimit, të shprehura në mënyrë të tillë që t’i shërbejnë kërkuarës të kuptojë se ç’masa duhet të marrë që, me një kërkesë të dytë, të mund të pajiset me licencën e kërkuar.

c) Vendimi i përcillet QKL-së, sipas procedurave dhe afateve ligjore të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

8. Mosdërgimi i vendimit brenda afatit 2 (javë) vlerësohet si miratim në heshtje, përveç rastit, kur para mbarimit të këtij afati, MASH-i shpall në regjistrin aplikativ, shtyrje afati për rastin përkatës. Shtyrja e pashallur në regjistrin aplikativ është e pavlefshme. Vendimi i shtyrjes sqaron domosdoshmërisht edhe shkaqet objektive të pamundësisë për shqyrtimin e kërkesës që e kanë diktuar atë. Shtyrja mund të përdoret vetëm një herë dhe ajo nuk mund të jetë më e gjatë se vetë afati përkatës i marrjes së vendimit.

9. Të drejtën e mbylljes apo pezullimit të përkohshëm të aktivitetit, deri në 1 vit kalendarik, të institucionit arsimor privat parauniversitar, e ka QKL-ja me kërkesë të vetë subjektit ose me propozim të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në rast shkeljeje të kriterëve të përcaktuara në dokumentacionin përkatës ligjor e nënligjor.

10. Në rast pezullimi të përkohshëm të veprimtarisë së institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar.

11. Në rast mbylljeje të aktivitetit të institucionit arsimor privat parauniversitar, sistemimi i nxënësve do të bëhet në bazë të nenit 48, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar.

## KREU II TARIFAT E SHËRBIMIT

1. Institucionet arsimore private parauniversitare dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare licencohen përkundrejt tarifave të përcaktuara si më poshtë:

Nr.	Institucionet	Tarifa në lekë
1	Për kopsht	35 000 (tridhjetë e pesë mijë)
2	Për shkollë të ciklit të ulët fillor	45 000 (dyzet e pesë mijë)
3	Për shkollë të ciklit të lartë 9-vjeçar	45 000 (dyzet e pesë mijë)
4	Për shkollë 9-vjeçare	55 000 (pesëdhjetë e pesë mijë)
5	Për shkollë të mesme të përgjithshme	70 000 (shtatëdhjetë mijë)
6	Për shkollë të mesme teknike-profesionale e social-kulturore	60 000 (gjashtëdhjetë mijë)
7	Për kurs plotësues (IAPPRP)	70 000 (shtatëdhjetë mijë)

**KREU III**  
**DETYRIMET E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT PARAUNIVERSITAR DHE INSTITUCIONIT**  
**ARSIMOR PLOTËSUES PRIVAT PARAUNIVERSITAR NDAJ MINISTRISË SË ARSIMIT DHE**  
**SHKENCËS**

1. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar pas fillimit të funksionimit të tij duhet:

a) Të paraqesë pranë DAR/ZA-së përkatëse:

- numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve që do të fillojnë dhe mbarojnë vitin shkollor sipas statistikave tip të miratuara nga INSTAT-i;

- planin mësimor, programet lëndore dhe strukturën që do të ketë institucioni në fillim të çdo viti shkollor;

- certifikatën e regjistrimit në organin tatimor;

- listën e veprimtarive jashtëshkollore që janë parashikuar të zhvillohen gjatë vitit shkollor (për institucion arsimor privat parauniversitar).

b) të kërkojë miratim për çdo ndryshim në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit, çdo ndryshim që ai mund të pësojë në vendndodhje, vendim gjykate, administrator etj.

2. Një institucion arsimor privat parauniversitar apo institucion arsimor plotësues privat parauniversitar duhet të ketë në ruajtje dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentacionin përkatës me ruajtje të përhershme, si: regjistër amze, indeks alfabetik, statistika të numrit të nxënësve dhe të mësuesve;

b) regjistra të veçantë dhe të përkohshëm, si: regjistra klase, evidencë, për lëvizjen e nxënësve (i detyrueshëm për institucionin arsimor privat parauniversitar), planet mësimore dhe programet lëndore të zbatuar çdo vit shkollor;

c) Rregulloren e brendshme për funksionimin e institucionit;

d) Kriteret për pranimin e nxënësve dhe të mësuesve;

e) Kontratat me prindërit për shërbimet arsimore apo shërbime të tjera jashtëshkollore që ofron;

f) Kontratat e punës me mësuesit (për ata me kohë të plotë apo të pjesshme).

Materialet duhet t'u vihen në dispozicion organeve kontrolluese kompetente.

3. Moszbatimi apo mosrespektimi i këtyre detyrimeve si dhe mosdhënia apo fshehja e këtyre informacioneve organeve kontrolluese kompetente, të cilat do të verifikojnë apo kontrollojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e këtyre institucioneve arsimore, përbën kundërvajtje administrative.

**KREU IV**  
**MIRATIMI I NDRYSHIMEVE NË DOKUMENTACIONIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE**  
**PRIVATE PARAUNIVERSITARE DHE INSTITUCIONEVE ARSIMORE PLOTËSUESE PRIVATE**  
**PARAUNIVERSITARE**

1. Ndryshimet në planin mësimor, programet lëndore apo tekstet që do të përdorë institucioni arsimor privat parauniversitar i licencuar, çdo projekt apo eksperimentim psiko-pedagogjiko-didaktik që kërkon të kryejë sipas rastit, si dhe çdo ndryshim tjetër që lidhet me anën kurrikulare të institucionit shqyrtohen dhe miratohen nga QKL-ja, pas miratimit të Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Privat (DZHAP).

2. Ndryshimet në vendndodhje dhe në infrastrukturën e godinës që mund të pësojë institucioni arsimor privat i licencuar shqyrtohen dhe miratohen nga QKL-ja, pas miratimit të Drejtorisë për Zhvillimin e Arsimit Privat (DZHAP), 3 muaj para fillimit të viti shkollor përkatës.

3. Ndryshimet që institucioni arsimor privat i licencuar mund të pësojë në vendim gjykate, administrator etj., shqyrtohen dhe miratohen nga QKL-ja në bazë të akteve të lëshuara nga QKR-ja.

**KREU V**  
**INSPEKTIMET DHE PEZULLIMI I LICENCËS**

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (IKAP) dhe institucionet e saj të varësisë në rrethe kontrollojnë periodikisht procesin mësimor në institucionet

private parauniversitare për të verifikuar realizimin e kërkesave të planit mësimor e të programeve lëndore të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

2. Nëse gjatë inspektimeve evidentohen shkelje të dispozitave të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, apo të këtij udhëzimi, të cilat grupi i inspektimit i cilëson si jothelbësore, atëherë grupi dorëzon pranë institucionit arsimor privat parauniversitar përkatës një listë të shkeljeve të evidentuara dhe një kërkesë për zbatimin e ligjit në fuqi apo të dispozitave të këtij udhëzimi.

Grupi i inspektimit përcakton rast pas rasti, në varësi të llojit të shkeljes, afatin brenda të cilit institucioni arsimor parauniversitar do të përmbushë kriteret apo do të ndreqë shkeljet e kryera. Institucioni ka të drejtë të ankimojë vendimin e grupit të inspektimit brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit.

3. Pas marrjes së njoftimit për shkeljet e konstatuara dhe për detyrimet për zbatimin e normave të përcaktuara në këtë udhëzim, institucioni dërgon një deklaratë të firmosur, në të cilën angazhohet se do të veprë sipas normave e do të respektojë standardet e vendosura në legjislacionin në fuqi dhe në këtë udhëzim. Në deklaratën e angazhimit renditen të gjitha shkeljet e evidentuara nga grupi i inspektimit.

4. Në rast se institucioni nuk arrin të zbatojë kërkesat brenda afatit të përcaktuar, MASH-i i propozon QKL-së marrjen e masave të duhura administrative, deri në pezullimin e licencës.

5. Parimet për përcaktimin e shkaqeve dhe të procedurave, për pezullimin/revokimin e licencës janë:

a) Përveçse kur parashikohet ndryshe, licenca pezullohet/revokohet kur institucioni arsimor privat parauniversitar nuk përmbush më kriteret e dhënies së licencës apo shkel detyrimet e përcaktuara në të.

b) Konstatimi i mosplotësimit të kritereve për licencim apo i shkeljes së detyrimeve bëhet, nga organet kompetente të inspektimit. Organet kompetente të inspektimit vënë në dijeni QKL-në për mosplotësimin e kritereve për licencim apo shkeljen e detyrimeve.

c) Përpara marrjes së vendimit të revokimit, QKL-ja urdhëron ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve, brenda një afati të arsyeshëm, pa pezullim të licencës dhe/ose pezullimin e licencës, për një afat të arsyeshëm, deri në zbatimin e urdhrit për ripërmbushjen e kritereve apo ndreqjen e shkeljeve të detyrimeve.

d) Urdhri i pezullimit revokohet nga QKL-ja, sipas legjislacionit në fuqi, kur vlerësohet se institucioni arsimor privat parauniversitar i ka plotësuar të gjitha urdhërimet, sipas rastit.

6. Nëse gjatë inspektimit evidentohen shkelje të rënda apo të përsëritura që bien në kundërshtim me këtë udhëzim, të cilat kanë sjellë dëme të konsiderueshme ndaj nxënësve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka të drejtë t'i kërkojë QKL-së pezullimin, për një vit, të veprimtarisë së institucionit kundërvajtës.

7. QKL-ja njofton MASH-in, drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore (DAR/ZA) përkatëse dhe Inspektoratin Kombëtar për Arsimin Parauniversitar (IKAP) për të gjitha licencat e pezulluara, si edhe publikon një listë vjetore të institucioneve arsimore për të cilat është pezulluar aktiviteti.

## KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

6.1 Udhëzimi i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.26, datë 7.9.2007 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes së funksionimit për institucionet arsimore private dhe institucionet arsimore plotësuese private parauniversitare” shfuqizohet.

6.2 Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria për Zhvillimin e Arsimit Privat, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme (Sektori Juridik) dhe Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
**Myqerem Tafaj**

**UDHËZIM**  
**Nr.35, datë 5.11.2010**

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË, TË  
STUDIMEVE ME KOHË TË PJESSHME DHE EDUKIMIN NË DISTANCË, NË  
INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, NË VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011”,

**UDHËZOJ:**

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas kritereve të përcaktuara dhe të bëra publike paraprakisht. Nuk pranohen aplikime nga kandidatët e shpallur fitues me formularët A2 dhe A3, të regjistruar në listat përfundimtare.

2. Kuotat e pranimeve sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.826, datë 13.10.2010 “Për kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe tarifave të shkollimit për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme e të edukimit në distancë, në vitin akademik 2010-2011” të përdoren në masën:

a) 80% për aplikantët që nuk ndjekin asnjë program studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë ose të pjesshme, në IAL-të publike.

b) 20% për aplikantët për program të dytë studimi, të cilët kanë përfunduar një program studimi.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë, të organizojnë procesin e pranimin dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Procesi të monitorohet nga rektoratet dhe Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së aplikimit për kandidatët që dëshirojnë të vijnë në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë. Këto njoftime të bëhen publike në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

5. Aplikimi për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme, të bëhet pranë sekretarive mësimore të njëjësive kryesore, ku aplikanti duhet të paraqitet personalisht dhe të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Fotokopje të noterizuar të dëftesës së pjekurisë së shkollës së mesme, ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të;

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë) dhe fotokopje të tyre. Në dosje të mbahet fotokopje e kartës së identitetit ose e pasaportës;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1500 lekësh në një nga bankat e nivelit të dytë;

e) Deklaratë që vërteton se aplikanti nuk ndjek ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme.

6. Në qoftë se aplikanti fitues nuk ka dëftesë pjekurie të shkollës së mesme, duhet të paraqesë dublikatë të saj, të lëshuar nga drejtoria e shkollës së mesme dhe të sigluar në Drejtorinë Arsimore rajonale/Zyrën arsimore përkatëse, ose listën e notave të shkollës së mesme të lëshuar nga Arkivi i Shtetit.

7. Aplikantët shqiptarë që kanë kryer shkollën e mesme jashtë shtetit dhe kërkojnë të vazhdojnë studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, duhet të dorëzojnë pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, edhe dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4, të udhëzimit nr/11, datë 2.4.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për kriteret e ekuivalentimit dhe regjistrimin në maturën shtetërore 2010 të shtetasve shqiptarë që kanë kryer

shkollën e mesme jashtë shtetit”. Sekretaritetë mësimore të njësisve kryesore i dërgojnë dosjet e këtyre aplikantëve, në komisionin për ekuivalentimin e dëftesave të shkollave të mesme të fituara jashtë vendit, në MASH.

8. Kandidatët që do të aplikojnë për regjistrim në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme dhe edukimin në distancë, në një program të dytë studimi, të dorëzojnë në sekretaritetë mësimore, përveç dokumenteve 5 edhe fotokopje të noterizuar të diplomës së lëshuar nga një institucion publik i arsimit të lartë ose fotokopje të noterizuar të ndonjë diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlefshme me të.

9. Aplikantët që do të regjistrohen në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të pjesshme në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikat 5, 6, dhe 7 të këtij udhëzimi, duhet t’u nënshtrihen edhe kriterëve të veçanta (konkurseve të pranimit), të vendosura nga ky institucion, për pranimet në ciklin e parë të studimeve me kohë të pjesshme, të bëra publike paraprakisht.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga datë 11.11.2010, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të pranimit të aplikimeve dhe të regjistrimit të aplikantëve fitues, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë.

11. Aplikimi i kandidatëve për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë, të zhvillohet nga data 15.11.2010 deri në datën 19.11.2020, prej orës 8:00 deri në orën 16:00 pranë sekretarive mësimore të njësisve kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

12. Institucionet publike të arsimit të lartë, të shpallin dhe të afishojnë në vende të dukshme, në mjediset e njësisve kryesore përkatëse, listat e kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, brenda orës 16:00 deri 23.11.2010.

13. IAL-të të dërgojnë në APRIAL brenda datës 23.11.2010, në formë elektronike, listat me aplikantët fitues, për të verifikuar nëse kandidatët janë të regjistruar në ndonjë program tjetër studimi me kohë të plotë ose të pjesshme. APRIAL-i kryen verifikimin dhe ua dërgon IAL-ve listën me kandidatët që ndjekin një program tjetër studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë ose të pjesshme, në IAL-të publike, nëse ka të tillë.

14. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë ku janë shpallur fitues, të zhvillohet prej orës 8:00 të datës 25.11.2010 deri në orën 16:00 të datës 27.11.2010, pranë sekretarive mësimore të njësisve kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë.

15. Regjistrimi i aplikantëve fitues të bëhet vetëm me dëftesën e pjekurisë së shkollës së mesme, origjinale, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 6 dhe 7 të këtij udhëzimi. Dokumentet e aplikantëve jofitues t’u kthehen atyre kundrejt kërkesës.

16. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në APRIAL, listat përfundimtare të kandidatëve fitues të regjistruar në datën 30.11.2010.

17. Aplikimi dhe regjistrimi i kandidatëve, për transferim studimesh, kryhet pas shpërndarjes nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, të kuotave të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1, të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve në statutet dhe rregulloret e IAL-ve publike.

18. Aplikimi për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë i kandidatëve nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe i shtetasve të tjerë të huaj që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë kryhet pas dërgimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të listës për shpërndarjen e kuotave të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1, të vendimit nr.826, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave. Regjistrimi dhe përzgjedhja e aplikantëve fitues, në programet e studimit të ciklit të parë në formën e studimit me kohë të pjesshme dhe të edukimit në distancë kryhet nga institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Pas mbylljes së procesit të të gjitha regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë, të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare me regjistrimet e kryera brenda datës 2.12.2010 në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikulimit”.



20. Këto njoftime të bëhen publike edhe në mediat e shkruara dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Drejtoria e edukimit parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Myqerem Tafaj

**UDHËZIM**  
**Nr.4846/33, datë 3.11.2010**

**PËR PROCEDURËN DHE AFATET E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT PAS  
ÇREGJISTRIMIT TË PËRMARUESIT GJYQËSOR PRIVAT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar dhe të nenit 38 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmarimor gjyqësor privat”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

1. Përmaruesi gjyqësor privat, pas çregjistrimit për një nga shkaqet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr.10 031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmarimor gjyqësor privat”, i ndryshuar, me urdhr të Ministrit të Drejtësisë, dorëzon në Ministrinë e Drejtësisë dokumentacionin e krijuar për çdo veprim procedural dhe vulën e tij. Në rastin kur përmaruesit gjyqësor privat i është hequr licenca dhe është çregjistruar për shkak të një dënimi penal të formës së prerë me burgim ose kur humbet zotësinë për të vepruar, dokumentacioni dhe vula dorëzohen nga një person i afërm i tij.

2. Dokumentacioni i krijuar prej përmaruesit gjyqësor privat të çregjistruar dhe vula e tij i dorëzohen punonjësit të strukturës përgjegjëse të ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë në urdhrin e këtij të fundit, të nxjerrë sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

3. Për dorëzimin e dokumentacionit dhe vulës, përmaruesi gjyqësor privat/personi i afërm, njoftohet me shkrim të paktën 5 ditë përpara për ditën dhe orën, në të cilën duhet të paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë për të kryer dorëzimin. Së bashku me njoftimin e dërguar nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, përmaruesit gjyqësor privat/personit të afërm i përcillet edhe një kopje e urdhrin të Ministrit të Drejtësisë. Ky njoftim i dërgohet njëkohësisht edhe Dhomës Kombëtare të Përmaruesve Gjyqësorë Privatë, e cila merr masat për njoftimin e përmaruesit/personit të afërm.

4. Në qoftë se përmaruesi gjyqësor privat/personi i afërm nuk paraqitet për dorëzimin e dokumentacionit dhe vulës, atij i bëhet edhe një njoftim i dytë, në të njëjtën mënyrë si njoftimi i parë.

5. Në rast se edhe pas njoftimeve sipas pikave 3 dhe 4 të këtij udhëzimi, përmaruesi gjyqësor privat nuk bashkëpunon për dorëzimin e arkivit, atëherë struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmaruesve Gjyqësorë Privatë, marrin masat e nevojshme për marrjen në dorëzim të dokumentacionit.

6. Për dorëzimin e dokumentacionit dhe të vulës mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga përmaruesi gjyqësor privat/personi i afërm dhe nga punonjësi i strukturës përgjegjëse, i ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë për të marrë në dorëzim dokumentacionin dhe vulën. Procesverbali hartohet në 3 kopje, prej të cilave një kopje mbahet në Ministrinë e Drejtësisë, një nga përmaruesit gjyqësor privat/personi i afërm dhe një kopje i dërgohet për dijeni Dhomës Kombëtare të Përmaruesve Gjyqësorë Privatë.

7. Pas dorëzimit të dokumentacionit dhe vulës, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, bën shënimet përkatëse në regjistrin e përmaruesve gjyqësorë privatë, në kolonat e emërtuara “Arkiva e përmaruesit privat” dhe “Marrja e vulave dhe asgjësimi i tyre”, sipas përcaktimeve të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë me nr.4864/26, datë 8.10.2010.

8. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë marrin masat për kalimin e arkivës së përmbauesit të çregjistruar një përmbauesi tjetër.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË  
Bujar Nishani

**VENDIM**  
**Nr.79, datë 3.11.2010**

**PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “AMAL” SHPK ME SERI PV03K, NR.09, LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TE KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.18, DATË 16.10.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 2.3 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, neneve 13, 14 dhe 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.11.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “AMAL” sh.p.k për ndryshimin e licencës nr.09, seria PV03K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.18, datë 16.10.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

1. Kërkesa që ka paraqitur shoqëria “AMAL” sh.p.k., në ERE për modifikimin e licencës është konform ligjit dhe në respektim të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

2. Procesi civil, për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka marrë vendim, ka si palë ndërgjyqëse personat fizikë z. Agim Elezi dhe znj. Luljeta Hysolli. Shoqëria “AMAL” sh.p.k., subjekt i procedurës për modifikimin e licencës, nuk është palë ndërgjyqëse në këtë proces gjyqësor.

3. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është ankimuar në Gjykatën e Apelit, pra nuk ka një vendim të formës së prerë lidhur me posedimin e kuotave të kapitalit themeltar të shoqërisë “AMAL” sh.p.k.

4. Akti administrativ i modifikimit të licencës lidhet direkt me rritjen e kapacitetit të asetit të licencuar (Hec Xhyre) dhe nuk ka pasoja të drejtpërdrejta mbi ortakët e shoqërisë “AMAL” sh.p.k.

5. Procesi gjyqësor i ndodhur mes palëve dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk e prek thelbin e çështjes për modifikimin e licencës, të “Hec Xhyre”, sipas procedurave dhe akteve nënligjore të miratuara në ERE.

6. Aseti (Hec Xhyre), dhënë me koncesion të formës ROT, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.486, datë 13.7.2003, apo licenca me nr.09, Seria PV03K, nuk janë objekt gjykimi.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e licencës nr.09, seria PV03K, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.18, datë 16.10.2003, për shoqërinë “AMAL” sh.p.k.

2. Fuqia e instaluar e “Hec Xhyre” nga 250 kW të bëhet 570 kW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s dhe të reflektojnë ndryshimet në licencë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s  
Bujar Nepravishta

**VENDIM**  
**Nr.80, datë 3.10.2010**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “FERAR ENERGY”  
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1 germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “a” dhe 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, neni 18 pika 1 germa “a”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 3.10.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ferar Energy” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ferar Energy” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Ferar Energy” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Benca” dhe Hec “Tepelena”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE- s**  
**Bujar Nepravishta**

**VENDIM**  
**Nr.187, datë 22.10.2010**

**PËR VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV AOS”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.849, datë 24.4.2009 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat vendor “Tv AOS” me nr. 063/TVL, pasi në mbarim të afatit të vlefshmërisë së licencës nuk ka shfaqur interes për rinovimin e saj.
  2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijani, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.188, datë 22.10.2010**

**PËR VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR**  
**“TV COLOR”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pika 1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.867, datë 12.6.2009 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat vendor “Tv Color” me nr. 069/TVL, pasi në mbarim të afatit të vlefshmërisë së licencës nuk ka shfaqur interes për rinovimin e saj.
  2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijani, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**VENDIM**  
**Nr.191, datë 22.10.2010**

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË TË DHËNAVE TË PARAQITURA NË KËRKESËN PËR  
MARRJE LICENCE NGA PERSONI FIZIK Z.ARDIAN DARDHA, LICENCUAR PËR  
SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR LUNA”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga

Endira Bushati	Kryetare
Alban Karapici	Zëvendëskryetar
Suela Musta	Anëtare
Sami Neza	Anëtar
Gent Ibrahimimi	Anëtar
Zylyftar Bregu	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Kërkues: z.Ardian Dardha

Objekt: Shqyrtim i kërkesës së paraqitur nga z.Ardian Dardha.

Baza ligjore: neni 7 pika 21, neni 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”,

**VËREN SE:**

Personi fizik z.Ardian Dardha është licencuar për operatorin televiziv privat kabllor “Tv kabllor Luna”, me vendimin nr.828, datë 24.4.2009, të KKRT-së. Me shkresën e datës 27.9.2010, subjekti person fizik Ardian Dardha ka paraqitur pranë KKRT-së kërkesën për ndryshimin e subjektit person fizik dhe kalimin e licencës në emër të subjektit z.Admir Leka.

Bashkëlidhur kërkesës, subjekti ka paraqitur certifikatën e regjistrimit të personit të tatueshëm, ekstraktin historik të regjistrimit tregtar, si dhe një deklaratë noteriale të datës 21.9.2010.

Sipas deklaratës noteriale:

“...z.Ardian Dardha, deklaroi se është pajisur me licencën nr.66, nga KKRT-ja, me emërtimin e “Tv kabllor Luna” dhe

z.Admir Leka, i regjistruar si person fizik pranë QKR-së Tiranë, me NIPT L 03301801 S, pas mbylljes së NIPT-it në QKR nga ana e z.Ardian Dardha.

Të dy të mësipërmët deklarojnë se do të jenë ortakë në aktivitetin sipas licencës së z.Ardian Dardha dhe do të punojnë me NIPT-in e z.Admir Leka ...”

Gjithashtu, sipas ekstraktit historik të datës 16.9.2010, vërtetohet se z.Admir Leka person fizik me fushë veprimtarie shpërndarje e sinjalit televiziv, është regjistruar në datën 1.9.2010. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është Tiranë, Luz i Vogël, Vorrozen, ndërtesë 1-katëshe, pranë qendrës.

Në mbështetje të nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sipas të cilit, për çdo ndryshim të të dhënave që janë paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës i licencuari duhet të japë edhe arsyet përkatëse, personi fizik z.Ardian Dardha ka parashtruar si më poshtë vijon:

“Në kuadër të përmirësimit të cilësisë të ritransmetimeve, larmisë së programeve dhe ndryshimeve të pritshme teknologjike, e ndjeva të nevojshme të investoja shuma të konsiderueshme në funksionimin e televizionit kabllor “Luna”...

Sa më sipër, isha i detyruar të kërkoja bashkëpunimin me ortakë të tjerë dhe së bashku të përballonim shpenzimet e planifikuara. Ky bashkëpunim më detyron që së bashku me z.Admir Leka, banues në Gosë të Kavajës, të njohur prej meje edhe në veprimtari të tjera të investojmë për përballimin e shpenzimeve ...”.

Mbështetur në nenin 22 të ligjit 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar: “Licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike

civile, objekt i të cilave është veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidatash.”

#### PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në bazë të nenit 7 pika 21, nenit 22 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

#### VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga z.Ardian Dardha, duke kaluar licencën për “Tv kabllor Luna”, në emër të personit fizik z.Admir Leka.
  2. T’i heqë subjektit fizik z.Ardian Dardha, licencën për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Luna”.
  3. Licenca me nr.066 RTV kabllor, bëhet e pavlefshme.
  4. T’i japë subjektit person fizik Admir Leka, licencë me afat vlefshmërie sipas përcaktimit të bërë në licencën nr.066 RTV kabllor, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor.
  5. Licenca e re ka të njëjtën përmbajtje me licencën nr.066 RTV kabllor, lidhur me kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e licencimit, kushtet teknike dhe tarifat.
  6. Ngarkohet administrata e KKRT-së për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE**  
**Endira Bushati**

**Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.**

**Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 30.11.2010

Doli nga shtypi më 1.12.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë